




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 07.08.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03-02-1430/15, për znj. Laura Pula – Prokurore në Zyrën e Prokurorit të Shtetit dhe z. Metush Biraj – Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, të dyshuar për konflikt interesi lidhur me propozimin për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit për z. Elez Hoxha, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi për znj. Laura Pula – Prokurore në Zyrën e Prokurorit të Shtetit dhe z. Metush Biraj – Prokuror në Prokurorinë Themelore në Prizren, të dyshuar për konflikt interesi lidhur me propozimin për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit për z. Elez Hoxha, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (më tutje Ligji PKI).

Në trajtimin e këtij rasti kemi pasur takim me znj. Pula dhe z. Biraj, si dhe kemi kërkuar shkresat e lëndës në Gjykatat dhe Prokuroritë përkatëse.

Dyshimet për konflikt interesi kanë qenë sepse, z. Elez Hoxha është vëllai i z. Sylë Hoxha (i cili në atë kohë ishte Kryeprokuror i Shtetit), ndërsa znj. Pula, në kohen ku është bërë propozimi për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit për të dënuarin Elez Hoxha, ka qenë zëvendëse e kryeprokurorit Sylë Hoxha.

Ndërsa, dyshimet për konflikt interesi për z. Metush Biraj kanë qenë sepse i njëjti ka qenë ushtrues detyre i Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prizrenit, në kohën kur z. Hoxha ishte Kryeprokuror i Shtetit.

Në takimin që kemi pasur me z. Biraj kemi kuptuar se praktika e Prokurorisë Themelore të Prizrenit është se të gjitha kërkesat për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit shqyrtohen nga kryeprokurorët.

Ndërsa për znj. Pula, në bazë të regjistrit të kërkesave për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, kemi konfirmuar se kjo lëndë i është ndarë në bazë të radhës rendore.

Fakti që znj. Pula ka qenë zëvendëse e prokurorit të shtetit, nuk ia mbron të drejtën asaj për të dhënë mendimin – propozimin lidhur me këtë rast. Kjo për arsye se në atë kohë Prokuroria e Shtetit ka pasur vetëm dy prokurorë: z. Jusuf Mejzini dhe znj. Laura Pula të cilët, në ushtrimin e funksioneve prokuroriale, janë të pavarur, të paanshëm dhe objektiv (Ligji për Prokurorinë e Shtetit neni 7, pika 1.1)

Në pajtim me këto dispozita, duke marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat relevante që i posedojmë në lidhje me çështjen e konfliktit të interesit për këtë rast, vlerësojmë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

